


Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Nr-DATË/A:	07Nr.279/350-4291 datë 14.04.2023
REFERENC-Ë:	07Nr. 350-4291 datë 17.01.2023
PËR/TO:	Astrit Hajdari, Adresa fshati Mushtisht-Suharekë
KOPJE/COPY:	Drejtorinë e Inspeksionit Drejtorinë për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër Dosje të Drejtorisë Arkivin e Komunës
NGA/FROM:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim
	Drejtori i Drejtorisë Visar KUÇI Punoi: Vlora NEZIRI
LËNDA/SUBJECT:	Aktvendim mbi Lejen Ndërtimore

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim, ka pranuar kërkesën 07Nr.350-4291 datë 17.01.2023 nga **Astrit Hajdari** nga Mushtishti Komuna Suharekë, për Leje Ndërtimore për objektin me destinim Depo për grumbullimin dhe ruajtjen e pemëve – Objekt i përkohshëm Montazh nga celiku me etazhitet P+0 në parcelat kadastrale nr.: 00748-3 ZK - Mushtisht pronë e Latif (Ramadan) Hajdari sipas çertifikatës me numër referues 4391/2022 e datës 29.12.2022 sipas Kontratës mbi dhënjën e paluajtshmërisë në shfrytëzim me kompensim Nr.LRP.14943/2022 dhe Nr.Ref. 3299/2022 e datës 06.09.2022 e noterizuar si dhe parcela kadastrale me nr.: 00747-0 ZK-Mushtisht pronë e Afrim (Rasim) Sopaj sipas çertifikatës me numër referues 4391/2022 e datës 29.12.2022 sipas Kontratës mbi dhënjën e paluajtshmërisë në shfrytëzim me kompensim Nr.LRP.18904/2022 dhe Nr. Ref 4401/2022 e datës 12.12.2022 e noterizuar. Parcelat ndërtimore të planifikuara me HZK janë Zonë Bujqësore-Zb me shfrytëzim të lejuar të veçant edhe për infrastrukturë bujqësore - Objekte për grumbullimin dhe trajtimin e produkteve Bujqësore. Andaj, pas shqyrtimit të lëndës ky organ vendosi, si në Aktvendimin e bashkangjitur kësaj shkrese.

- **AKTVENDIM MBI LEJEN NDËRTIMORE**



Data: 14.04.2023

Numri i vrojtimit të lejes:

07Nr.279/350-4291

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Në bazë të nenit 21 të LPH nr.04/L-174 datë:31.07.2013, nenit 18 të LN nr.04/L-110 datë:31.05.2012, neni 13 paragrafi 4 pika 2 i UA-06/2017 Për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për Kushte ndërtimore, Leje ndërtimore dhe Leje rrënimi për kategorinë e I dhe të II të ndërtimeve, UA Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor datë 09.06.2017, Hartës Zonale të Komunës së Suharekës 2022-2030 01Nr.016-69078 datë 28.10.2022, si dhe neneve 44, 47, 48 dhe 125 të LPPA nr.05/L-031, DUP në Suharekë lëshon këtë:

**AKTVENDIM
(MBI LEJE NDËRTIMORE)**

Kjo leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	Astrit Hajdari	Emaili:	[REDACTED]
Adresa	Mushtisht-Suharekë	Kërkesa Bazë:	Aplikim për Leje ndërtimore: 07Nr.350-4291 datë 17.01.2023

Emri i Projektit:	Depo për grumbullimin dhe ruajtjen e pemëve-Objekt i përkohshëm montazh nga celiku P+0
Emri i Projektuesit:	Gllareva Projekt SH.P.K.
Adresa:	Gllogovc
Emaili:	[REDACTED]

Për punët ndërtimore në vijim: NDËRTIM I RI, KATEGORIA I-Leje e përkohshme			
Adresa: Rruga "Rugova" Mushtisht – Komuna Suharekë			
Zona(t) Kadastrale: Mushtisht	Nr. i parcelave kadastrale:	GPS Koordinatat e objektit:	
Certifikata me numër referues 4391/2022 e datës 29.12.2022 pronë e Latif (Ramadan) Hajdari si dhe Certifikata me numër referues 4391/2022 e datës 29.12.2022 pronë e Afrim (Rasim) Sopaj.	00748-3 dhe 00747-0	Y=7488757.992 Y= 7488750.210 Y=7488766.214 Y=7488768.780 Y=7488767.016 Y=7488772.232	X=4686053.455 X=4686059.233 X=4686080.789 X=4686078.884 X=4686076.508 X=4686072.636

Lloji i ndërtimit të propozuar:
Depo për grumbullimin dhe ruajtjen e pemëve- Objekt i përkohshëm montazh nga celiku P+0
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:
Kategoria I

Gabariti:	Me sipërfaqe bruto të objektit 248.48m²	Katshmëria:	P+0
Vija rregullative:	Nga aksi i profilit të rrugës së planifikuar "Rugova" 23.50m'	Vija ndërtimore:	Nga vija rregullative e rrugës së planifikuar "Rugova" 7.00m'

Përshkrimi

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore të përkohëshme Astrit Hajdari nga fshati Mushtisht Komuna Suharekë i lejohet ndërtimi i objektit me destinim Depo për grumbullimin dhe ruajtjen e pemëve - Objekt i përkohshëm montazh nga celiku me etazhitet P+0 në afat prej 15 viteve konform kontratave, Kontratës mbi dhënjen e paluajtshmërisë në shfrytëzim me kompensim Nr.LRP.14943/2022 dhe Nr.Ref. 3299/2022 e datës 06.09.2022 e noterizuar si dhe Kontratës mbi dhënjen e paluajtshmërisë në shfrytëzim me kompensim Nr.LRP.18904/2022 dhe Nr. Ref 4401/2022 e datës 12.12.2022 e noterizuar.

Lokacioni i objektit është në kuadër të Hartës Zonale të Komunës së Suharekës 2022-2030 01Nr.016-69078 datë 28.10.2022 ku sipas gjendjes së planifikuar, parcelat kadastrale 00748-3 dhe 00747-0 është Zonë Bujqësore -Zb me shfrytëzim të lejuar të veçant edhe për infrastrukturë bujqësore - Objekte për grumbullimin dhe trajtimin e produkteve Bujqësore, sipas projektit kryesor hartuar nga: **"Gllareva Projekt SH.P.K. Gllogove.**

Objekti ka karakter të përkohshëm në afat prej 15 viteve me etazhitet P+0. Ndërtimi i objektit të bëhet konform projektit të pranuar nga DUP e të nënshkruar me numër të Lejes Ndërtimore. Objekti është lejuar të ndërtohet me sipërfaqe në përdhese 248.48m².

Kjo leje ndërtimore lëshohet në bazë të aplikacionit dhe informatave mbështetëse. Ndërtimi të bëhet në përputhje me dokumentet e aprovuara ndërtimore. Çfarëdo ndryshimi i projektit duhet të aprovohet nga hartuesi i projektit dhe nga ky organ.

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Puna në ndërtim duhet të fillojë brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin.
- Të vendos tabelën informuese në vendndërtim me informata e mëposhtme:
 - Informata mbi Lejen Ndërtimore.
 - Informata mbi Projektuesin.
 - Informata mbi Kontraktuesin.
 - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit.
- Duhet të siguroheni se kontraktuesi në vendndërtim i posedon dokumentet e mëposhtme:
 - Një kopje të kësaj leje ndërtimore.
 - Nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë, një kopje e kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit.
 - Një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent.
 - Projektin Kryesor me të gjitha fazat për nevoja të realizimit të ndërtimit.
 - Dokumentacioni që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, Kodin dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit.
 - Librin dhe ditarine ndërtimit, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur.

- Protokolet e miratuara të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit.
 - Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit në paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore.
- Duhet të njoftojë organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj dhe akte nënligjore dhe Kod. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuata dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore. Në rast të mos respektimit të Lejes së ndërtimit si dhe në çdo parregullsi që haset në teren inspektori përgjegjës duhet të njoftoj me shkrim organin kompetent në mënyrë që të veprohet në përputhje me dispozitat ligjore. Nëse gjatë punimeve haset në elemente arkeologjike, Investitori është i obliguar ti ndërpresë punimet dhe të njoftoj organet komunale.
- Të njoftojë organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga Projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveç në rastet kur:
 - o Ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret në fuqi.
 - o Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një(0.1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore.
 - o Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, kodet dhe rregulloret teknike në fuqi.
 - Obligohet investori që gjatë gërmimit dhe ndërtimit të objektit të bëjë pastrimin e materialit të panevojshëm për punë dhe se të njëjtin ta transportojë në deponinë për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, në lokacionin e përcaktuar nga Kuvendi Komunal.
 - Pas përfundimit të punëve ndërtimore dhe pranimit teknik të të gjitha fazave, të aplikojë për certifikatë të përdorimit në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore.

A r s y e t i m

Aplikuesi **Astrit Hajdari** nga Mushtishti Komuna Suharekë përmes kërkesës 07Nr.350-4291 datë 17.01.2023, ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejes Ndërtimore për ndërtim të objektit me destinim Depo për grumbullimin dhe ruajtjen e pemëve – Objekt i përkohshëm Montazh nga celiku me etazhitet P+0, sipas projektit të bashkangjitur.

Kjo leje ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Njoftim rreth Kushteve Ndërtimore 07Nr. 816/350-64478 datë 27.12.2022 (kopje)
- Pëlqim për largimin e mbeturinave Nr.304/22, datës 29.12.2022 lëshuar nga Kompania Regjionale për Mbeturina “ECO-REGJIONI”- Prizren, Njësia operative Suharekë.
- Vërtetimin e Ujësjellësit dhe Kanalizimit–Hidroregjioni Jugor Prizren datë 29.12.2022.
- Pëlqim për kushtet e sigurisë në komunikacion rrugor–nga Inspektori i Komunikacionit Rrugor 09Nr.19 datë 17.01.2023.
- Pëlqim parimor nga KEDS-SH.A, Nr.12, datë 13.01.2023.
- Pëlqim në dokumentacion teknik mbi masat e parapara për mbrojtje nga zjarri, Nr.03/03-4, datë 17.01.2023 nga Drejtoria e Shërbime Publike Mjedis dhe Emergjencë.
- Koordinatat e vendosjes së objektit sipas skicës së terrenit me nr. të lëndës 18/2023 të datës 13.01.2023 të punuar nga gjeodeti i licencuar Hekuran H. Demiri me nr. të licendës 151 si dhe referuar projektit kryesor të hartuar nga “Gllareva Projekt” SH.P.K. Glllogovc.
- Kontrata mbi dhënjen e paluajtshmërisë në shfrytëzim me kompensim Nr.LRP.14943/2022 dhe Nr.Ref. 3299/2022 e datës 06.09.2022 e noterizuar si dhe Kontrata mbi dhënjen e paluajtshmërisë në shfrytëzim me kompensim Nr.LRP.18904/2022 dhe Nr. Ref 4401/2022 e datës 12.12.2022 e noterizuar.
- Tri kopje të projektit zbatues dhe kopje elektronike

- Kopje e planit dhe çertifikata e pronësisë
- Deklarata e përbashkët e inxhinierëve, Vendimi, deklaratat e veçanta të inxhinierëve për fazat e tyre (datë: shkurt 2023).
- Vërtetimin e tatimit në Pronë 04.N.1226 datë 13.03.2023
- Kopja e dokumentit identifikues
- Njoftimi për plotësim lënde 07Nr.65/350-4291 datë 10.02.2023
- Njoftimi për pagesë (taksa administrative 596.21€) 07Nr.175/350-4291 datë 13.03.2023, parashtruesit të kërkesës i është caktuar lartësia e pagesës për leje ndërtimore në shumën prej 596.21€ dhe se për pagesën e kryer është sjellë dëshmia nga I.F.J.B. Vilesa-Co – Suharekë me datë 13.03.2023 sipas faturës komunale Nr. 001056 e datës 13.03.2023.

Ky organ përmes shërbimit të vet profesional pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumenteve tjera përcjellëse, bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, Hartës Zonale të Komunës së Suharekës 2022-2030 01Nr.016-69078 datë 28.10.2022, ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejës Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

Udhëzim juridik: Kundër kësaj Leje Ndërtimore pala e pakënaqur mund t'i paraqitet ankesë MMPHI në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e dorëzimit përmes këtij Organi.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim – Komuna Suharekë
Numri i vrojtimit i lejes 07Nr.279/350-4291 datë 14.03.2023

Vendimi i dërgohet:
Parashtruesit të kërkesës;
Inspektoratit të Komunës;
DSHPJK-së
Dosjes së DUP-së

Drejtori i Drejtorisë:
Visar KUÇI

